



## REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

### Shtabi për Gatishmëri Emergjente



### INFORMATË

#### **Për pastrimin e rrugëve lokale nga bora në Komunën e Vushtrrisë, nga data 31.01. - 21.02.2012**

Drejtoria për Shërbime Publike, aktivitetin për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve e ka filluar prej datës 15.11.2011, me ç'rast janë ndërmarrë të gjitha masat për mirëmbajtje sa më cilësore të të gjitha rrugëve lokale të Komunës sonë. Kompania fituese e tenderit për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale të Komunës së Vushtrrisë është "Shkoza FO7" e cila ka arritur që me sukses të mirëmbajë të gjitha rrugët lokale.

Mirëpo siç dihet, të reshurat e mëdha të borës dhe erës së fuqishme që zgjatën disa ditë me radhë në Komunën tonë sikurse edhe gjithë rajonin, sidomos në ditët e para të muajit shkurt të këtij viti, imponoj nevojën që të formohet Shtabi emergjent për menaxhimin e situatës në teren. Kështu që Kryetari i komunës duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Fatkeqësitë Natyrore dhe fatkeqësitë tjera elementare me datën 07.02.2012, formoj shtabin për gatishmëri emergjente me qëllim të menaxhimit të gjendjes së krijuar nga reshjet e mëdha të borës si dhe ndërmarrjes së masave për tejkalim të situatës emergjente të krijuar. Duke u nisur nga një situatë e tillë e krijuar, me propozim të shtabit, dhe me vendim të Kryetarit të komunës nga data 07.02.2012 u ndërmorën këto veprime dhe masa për tejkalim të gjendjes së krijuar:

- Me urdhër të Kryetarit të Komunës, Qeveria komunale ka ngritë nivelin e gatishmërisë 24 orë për mbështetje shtabit emergjent
- Shtabi emergjent u obligua që të punoj me orar të zgjatur të punës sipas nevojës deri vonë në mesnatë.
- U formuan ekiye mobile shëndetësore për intervenim emergjent në teren për raste të sëmundjeve,
- U Koordinuan aktivitetet me Qendrën Operative emergjente në nivel qendror – përfaqësuesi i kësaj qendre ishte prezent çdo ditë në komunën tonë i cili ka koordinuar punët dhe aktivitetet për menaxhim të situatës në teren.
- U Koordinuan aktivitetet gjithashtu edhe me Policinë e Kosovës e cila ka ndihmuar për menaxhim më të mirë të situatës në teren, si dhe njësinë e zjarrfikësve në Vushtrri e cila gjithashtu e cila iu ka dalë në ndihmë kompanive në teren për pastrimin e rrugëve nga bora.
- Bizneseve të komunës, institucioneve publike, shoqatave dhe qytetarëve iu bë apel që të ndërmarrin masa të pastrimit e sipërfaqeve para hyrjeve të objekteve të tyre dhe pullazeve. Për mbikëqyrje të gjithë kësaj u obligua Drejtoria për inspektion. U muar vendimi që familje të bllokuara nga bora dhe familje skamnore të ndihmohen me nga një pako ushqimore dhe 25 kg. miell, në vlerë prej 50 €,
- U angazhuan kompani shtesë të komunës me mekanizmin për pastrim të rrugëve nga bora. Këto kompani u angazhuan në mënyrë vullnetare dhe pa pagesë në marrëveshje me komunën – por të furnizohen me derivate të naftës.

- U koordinuan aktivitetet me kryqin e kuq në Vushtrri për ofrim të ndihmave në ushqim dhe artikuj tjerë elementar për jetesë për familjet në gjendje të rëndë material dhe ato të bllokuara nga bora.
- Zyra për informim u obligua që të informoj opinionin për masat që po ndërmerren si dhe mundësitë që qytetarët të kenë qasje të pandërprerë me shtabin emergjent të komunës,

Qendra operative e koordinimit emergjent ka hartuar planin për koordinim me të gjitha njësitë në teren: planin e radio lidhjeve dhe telefonik. Të gjitha njësitë kanë qenë të pajisura me radio lidhje të kyçura në radio-rrejetin emergjent të komunës i cili funksionon 24 orë.

Nga dita e parë rrugët kanë qenë kryesisht të hapura për qarkullim dhe jeta është zhvilluar normalisht pa pengesa të mëdha.

Kjo situatë është menaxhura pandërpre nga shtabi, ku ka ndërmarrë të gjitha masat për mbrojtjen e popullatës nga rreziqet e mundshme nga bora. Një familje me 4 anëtarë nga Shallci është evakuua te i afërmi për shkak të rrezikut nga rrënimi i shtëpisë në të cilën ka banua.

#### **Prioritetet gjatë punës së shtabit emergjent:**

- Hapja e rrugëve për rastet e intervenimeve mjekësore - rastet emergjente të të sëmurëve në dializë, dhe sëmundje tjera,
- Furnizimi me ushqim i familjeve të bllokuara nga bora dhe atyre në nevojë,
- Hapja e rrugëve në rastet e varrimeve që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe etj.

#### **Kompanitë e angazhuara dhe punët e kryera në teren:**

Kompania kontraktuese, prej datës 31.01.2012-20.02.2012 ka kryer punë në vlerë:

| Nr.                | Përshkrimi i shërbimeve                   | Njësia         | Sasia | Çmimi për njësi € | Shuma           |
|--------------------|-------------------------------------------|----------------|-------|-------------------|-----------------|
| 1.                 | Furnizimi, transporti dhe hedhja e kripës | tonë [t]       | 32    | 70 €              | 2 240 €         |
| 2.                 | Furnizimi, transporti dhe hedhja e rërës  | m <sup>3</sup> | 15    | 11 €              | 165 €           |
| 3.                 | Puna efektive e kamionit I                | orë [h]        | 195   | 35 €              | 6 825 €         |
| 4.                 | Puna efektive e kamionit II               | orë [h]        | 133   | 35 €              | 4 655 €         |
| 5.                 | Puna efektive e ngarkuesit                | orë [h]        | 187   | 35 €              | 6 545 €         |
| 6.                 | Kujdestaria                               | orë [h]        | 1512  | 1.5 €             | 2 268 €         |
| <b>T O T A L I</b> |                                           |                |       |                   | <b>2 2698 €</b> |

Ndërsa në bazë të planifikimit-projektit të Drejtorisë për Shërbime Publike në qytet janë mirëmbajtur 18 470 [m] rrugë dhe trotuare apo 77 030 [m<sup>2</sup>], ndërsa në fshatra 91 400 [m] apo 274 200 [m<sup>2</sup>]

**Gjithsej:**109.87 [km] rrugë apo 351 230 [m<sup>2</sup>]

Shtabi për Gatishmëri Emergjente pas situatës së krijuar ka angazhuar edhe 13 Kompani dhe 7 individë vullnetarë me mekanizmin e tyre të cilëve u është bërë kompensimi i derivateve.

Kompanitë tjera të angazhuara prej datës 07.02.2012 deri më 20.02.2012

| Nr .               | Kompania              | Përshkrimi i punëve                                                              | Ditë pune | Orë pune | Sasia e derivateve [l] |
|--------------------|-----------------------|----------------------------------------------------------------------------------|-----------|----------|------------------------|
| 1.                 | Hysnia                | Ngarkuesi:pastrim bore në lagje të fshatrave,<br>Kamioni: largim bore nga qyteti | 14        | 285 h    | 1 219.56 [l]           |
| 2.                 | Kopshti               | Dy ngarkues dhe dy kamionë (qytet)                                               | 4         | 156 h    | 1 560 [l]              |
| 3.                 | Wenda                 | Dy ngarkues dhe kamioni (Qytet)                                                  | 11        | 281 h    | 816 [l]                |
| 4.                 | KRM Uniteti           | Ngarkuesi dhe dy kamionë (qytet)                                                 | 4         | 93 h     | 380 [l]                |
| 5.                 | Ujësjiellësi Vushtrri | Ngarkuesi (qytet)                                                                | 6         | 46 h     | 300 [l]                |
| 6.                 | Andi                  | Ngarkuesi (Dumnicë)                                                              | 7         | 71 h     | 620 [l]                |
| 7.                 | Vëllezërit Caka       | Ngarkuesi (Stanoc)                                                               | 5         | 27.5 h   | 290 [l]                |
| 8.                 | Xeti                  | Ngarkuesi dhe kamioni (qytet)                                                    | 11        | 208 h    | 772 [l]                |
| 9.                 | Toni Comerc           | Dy ngarkues (lagjet ne fshatra)                                                  | 1         | 20 h     | 416 [l]                |
| 10.                | Florenti              | Ngarkuesi (lagjet në fshatra)                                                    | 1         | 10 h     | 111 [l]                |
| 11.                | Kuqi                  | Ngarkuesi (lagjet në fshatra)                                                    | 4         | 32 h     | 370 [l]                |
| 12.                | Orllati               | Ngarkuesi (lagjet në fshatra)                                                    | 5         | 40 h     | 369 [l]                |
| 13.                | Hyseni                | Ngarkuesi (lagjet në fshatra)                                                    | 6         | 37.5 h   | 200 [l]                |
| <b>T O T A L I</b> |                       |                                                                                  | 65        | 1307 h   | 7423 .56 [l]           |

**Vullnetarë tjerë të angazhuar prej datës 07.02.2012 deri më 20.02.2012**

| Nr                 | Emri e mbiemri  | Pajisja  | Sasia e derivateve [l] |
|--------------------|-----------------|----------|------------------------|
| 1.                 | Remzi Parduzi   | Traktor  | 80 [l]                 |
| 2.                 | Xhevdet Parduzi | Traktor  | 100 [l]                |
| 3.                 | Avni Ademi      | Traktor  | 50 [l]                 |
| 4.                 | Kryqi i Kuq     | Automjet | 71 [l]                 |
| 5.                 | Ibër Lepenci    | Ngarkues | 40 [l]                 |
| 6.                 | Beqir Xhafa     | Traktor  | 140 [l]                |
| 7.                 | Zekri Muzaqi    | Traktor  | 85 [l]                 |
| <b>T O T A L I</b> |                 |          | 566 [l]                |

**Kostoja financiare :**

- Kompania kontraktuese:..... 22.698 €
- Kompanitë tjera, (derivate të naftës): ..... 10.227 €
- Ndihmat me artikuj të domosdoshëm ushqimorë (90 pako ushqimore në vlerë prej..... 4.500 €
- Furnizimi me ushqim për punëtorë të kompanive ..... 378 €

---

GJITHSEJTË ..... 37.803 €

**Ndihmat janë shpërndarë si vijon:**

- Vushtrri, 22 pako, Karaqë 1, Pasomë 1, Prelluzhë 5, Druar 4, Ashlan 1, Akrashticë 1, Bajskë 2, Beqiu 1, Zagori 2, Shitaricë 2, Tërllabuq 4, Sllakoc 1, Mihaliq 3, Bequk 2, Stroc 1, Bukosh 4,

Lummadh 1, Shallc 4, dobërllukë 1, Dumnicë 1, Samadrexhë 1, Balinc 4, Kollë 1, Liqej 5, Stanoc 4, Maxhunaj 1, Kurillovë 5, Vesekoc 5.

#### **Ndihmat nga Kryqi i Kuq i Kosovës, dega në Vushtrri:**

- Miell, pako ushqimore, pako higjienike dhe batanije
- Fshatrat e ndihmuara: Gumnishtë, Skromë, Vesekoc, Zagoi, Ceceli, Ropicë, Vilanc, Balinc, Liqej, Taraxhë, dhe Bukosh.
- Shuma e ndihmës për qdo familje: 56.30 €
- Shuma totale e ndihmës së ofruar : 1.126.00 €

Këto ndihma ishin donacion i Kryqit të Kuq Shqiptar.

-Ndërkaq nga e mërkura (22 shkurt) ka arritur edhe kontingjenti tjetër me ndihma për 50 familje të cilat janë duke u shpërndarë. Në donacion ka 50 kg miell, pako ushqimore dhe pako higjienike për 50 familje.

Shpërndarjen është duke e bërë Dega e Kryqit të Kuq të Kosovës në Vushtrri, ndihmat janë donacion i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

- Gjithashtu nga një donacion i Gjysmë hënës së kuqe të Turqisë përmes Kryqit të Kuq të Kosovës me ndihma ushqimore janë ndihmuar 6 familje në Skromë dhe Boshlan.

#### **Dëmet materiale:**

Janë formuar komisione profesionale për vlerësim të dëmeve në teren. Sipas të dhënave të komisioneve, janë dëmtuar 3 shtëpi pjesërisht dhe 2 objekte përcjellëse.

Lidhur me dëmet në bujqësi (serra etj.), komisioni do të informoj në ditët në vijim, pasi që deri tani nuk ka arrit ta përfundoj punën.

#### **Problemet dhe vështirësitë:**

- Kërkesat e mëdha dhe të përnjëhershme të qytetarëve për pastrim të rrugëve nga bora,
- Tereni i papërshtatshëm në disa lokalitete ku për pasoj është dashur të intervenohet në heqjen e mekanizmit pas rrëshqitjeve jashtë rrugës.
- Në zonat kodrinore malore (Skromë, Boshlan, Vesekoc, Gumnishtë, Kurillovë), trashësia shumë e madhe e borës ku në disa raste ka qenë e pa mundur për të hap disa rrugë.

#### **Përfundim:**

Me gjithë problemet e paraqitura konsiderojmë se shtabi emergjent me përgjegjësinë më të madhe ka ndërmarrë të gjitha masat, procedurat dhe aktivitetet e duhura duke azhuruar dhe mundësuar realizimin e planit operativ për menaxhim të situatës në teren dhe se angazhimet e kompanive kanë qenë në përputhje me kërkesat e shtabit dhe nevojave të qytetarëve për tu siguruar lëvizje të lirë. Konsiderojmë gjithashtu që menaxhimi i situatës në teren është kryer me mjaft sukses ku shtabi ka marrë falënderime dhe përkrahje nga qytetarët.

Shtabi emergjent i falënderon të gjitha kompanitë vullnetare që kanë vepruar në teren dhe qytetarët të cilët kanë ndihmuar në tejkalimin me sukses të situatës së rënduar nga bora.

Shtabi emergjent i falënderon gjithashtu OJQ “Koha” dhe “Forca” të cilat kanë ndihmuar në pastrimin e borës në hapësirat e memorialit të Dëshmorëve dhe Martirëve.

-----

Shtabi Emergjent vazhdon të përcjell situatën në teren për shkak të ekzistimit të mundësisë së reshjeve në ditët në vijim dhe mundësive për vërshime në disa fshatra të komunës ku janë ndërmarrë masa dhe evidentua pikat e mundshme të vërshimeve si dhe janë caktuar masat dhe mjetet teknike që duhet përdoren gjatë këtyre situatave. Për këtë, është informuar me shkrim AME.

Shtabi edhe më tutje është në gjendje të vëzhgimit të situatës në gjithë territorin e komunës.

Naim Hyseni

Kryetar i Shtabit